



REPUBLIKA E KOSOVËS-REPUBLIKA KOSOVA REPUBLIC OF KOSOVO
KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

Pranuar / Dorezuar Primjenol/Prodato Received/Delivery	12.05.2021	viti god. year	1
Organ /Njesia Organ./Jedinica Org./Unit	Nr Prot Br Prot Prot No	Shtojca Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity
SKPMShCK	2367/2021		1/4



Republika e Kosovës Republika Kosova - Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A.nr.207/2021

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave në përbërje nga: Arben Mehmeti-kryetare, Ardita Haxhnikaj Demi dhe Eshref Shabani-anëtar si dhe Zyle Millaku Gojnovci-Zyrtare e lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtësit, ka shqyrtuar ankesën e datës 01.04.2021 me numër A.nr.207/2021, e parashtruar përmes postës elektronike E-mailit zyrtar: ankesa.kpmschck@rks-gov.net me datë 30.03.2021, nga ankuesi me adresë elektronike: _____, në zyre të Qendrës Komunale për Regjistrimin e Bizneseve në Komunë të Malishevës, kundër Komunës së Malishevës, në çështjen juridike "Kërkesë nga marrëdhënia e punës" duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.7 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregulloren Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim, me datë 11.05.2021, mori këtë:

V E N D I M

HEDHET POSHTË si e palejuar ankesa me numër A.nr.207/2021 e datës 01.04.2021 e parashtruar nga ankuesi

A r s y e t i m

Ankuesi _____ i punësuar në Komunën e Malishevës në vendin e punës: "Zyrtar për të Ardhura", në Drejtorinë e Ekonomisë, Financave dhe Buxhetit sipas Akt emërimit nr.01/163 të datës 24.01.2012, i pa kënaqur me mos përgjigjen e Komunës së Malishevës, në Kërkesën e datës 18.01.2021 të drejtuar tek Kryetari i Komunës së Malishevës, Drejtori i Drejtorisë për Ekonomi, Financa dhe Buxhet, Njësisë së Personelit, dhe Zyrës së Auditorit të Brendshëm, me datë 30.03.2021 përmes postës elektronike E-mailit, ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, të regjistruar me datë 01.04.2021 me numë Protokolli 1528/2021, me pretendime ankimore për mos përgjigje në Kërkesën e datës 18.01.2021, lidhur me pretendimet

Handwritten signature and stamp in the bottom right corner.

ankimore për mos ndryshimin e Akte emërimit sipas punëve që është duke ekzekutuar dhe mos zbatimin e ligjit nga ana e Kryetarit të Komunës së Malishevës dhe Zyrës së personelit.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, më datë 12.04.2021, ankesën e ankueses e ka proceduar për përgjigje në ankesë tek Komuna e Malishevës. Këshilli me datë 27.04.2021 ka pranuar përgjigjen në ankesë nga Komuna e Malishevës, me dokumentacionin e bashkangjitur lidhur me ketë lëndë.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, me qëllim të vërtetimit të plotë dhe të drejtë të gjendjes faktike, për marrjen e vendimit meritore ka administruar këto prova: Ankesën A.nr.207/2021 e pranuar ne Këshill me date 01.04.2021, me numër protokolli 1528/2021, e parashtruar me datë 30.03.2021 përmes postës elektronike E-mailit zyrtar, të Këshillit Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Diplomën universitare të ankuesit nr. 311 e datës 05.09.2002; Certifikatën e datës 15.12.2010; Certifikatën e datës 14.12.2012; Certifikatën e datës 02.10.2020; Form:MAP/AE/02; Kopje e konkursit të brendshëm i datës 30.06.2020; Kërkesë për punësim e datës 06.04.2020; Vendim Nr.01/620 i datës 03.07.2020; Raport i performancës QKRB-ve korrik-shtator 2020 ½ faqe; Kërkesë e datës 18.01.2021 nr. 01/13 drejtuar Kryetarit të Komunës, Drejtorit të drejtorisë për ekonomi, financa dhe Buxhet, Zyrës së personelit dhe Zyrës së auditorit të brendshëm; Kërkesa e datës 12.04.2021 nga Këshilli lidhur me pretendimet e ankuesit me numër protokolli 1728/21; Përgjigje në ankesë e datës 27.04.2021 nga Komuna e Malishevës, me numër protokolli 2020/21, me provat e bashkangjitura, si në vijim: përgjigje e datës 23.04.2021 nr.01/261; Kërkesë e datës 10.06.2019 Akte emërimi nr.01/163 i datës 24.01.2012; Përshkrimi i detyrave të punës i datës 20.04.2021; Kopje e konkursit të brendshëm i datës 30.06.2020 nr.01-584; E-mail i datës 15.04.2021 ½ faqe; Konkurs i datës 07.05.2021 deri 22.05.2021; Kërkesë për punësim e datës 06.07.2020 nr,1/626, bashkangjitur dokumentacionit të ankuesit, Diplomën Universitare nr.311, Certifikatën e lindjes, Certifikatat e tjera të datës 15.12.2010, të datës 14 nov.-dec.2012, të datës 01.07.2008, të vitit 2001, të datës 1-12 korrik2002, Certifikatën e datës 03.07.2020 Gjykatës themelore në Gjakovë, Vërtetim mbi përvojën e punës e datës 03.07.2020; Raporti i përgjithshëm nga procedura e rekrutimit; Shkresa e datës 28.07.2011 pranuar nga ARBK, Certifikatë e datës 25.06.2020; Formular i vlerësimit të rezultateve të punës (pa datë); Kërkesë për punësim i datës 02.07.2020 NR. 01/606 nga bashkangjitur dosjen e aplikuesve, CV, Vërtetimin datë 01.07.2020 nr.01/601, Certifikatës se datës 01.07.2020 të Gjykatës themelore në Gjakovë, Certifikatën e lindjes të datës 01.07.2020, Formular i vlerësimit të rezultateve të punës i datës 31.12.2018, Formular i vlerësimit të rezultateve të punës i datës 31.12.2019, Diplomë universitare e datës 31.01.2014 nr.603, Diplomë Universitare nr.1054; Certifikatë - LGA, Letër reference e datës 13.08.2015, Vërtetim i datës 19.02.2010, Referencë e SHF "Petro Nini Luarasi", Llapcevë, Vërtetim i punës i datës 11.05.2007 nr.79/0104, Referencë nr.06/05, Certifikatë e datës 15.05.2009, e datës 12-13.10.2009, e datës 01.12.2012, e datës 15.07.2005, e datës 28.04.2009, e datës 30.06.209, Referencë e datës 16.02.2010, Certifikatë e datës 30.09.2006, e datës 07.12.2008, Vërtetim i datës 29.02.2008, Vërtetim i datës 11.02.2008, Certifikatë e datës 14.04.2002, e datës 12.04.2001, e datës 01.12.2012, Kërkesë për punësim i datës 07.07.2020 nr,1/641, bashkangjitur dokumentacionin, Diplomë



Universitare e datës 17.05.2017, Certifikatë e datës 06.07.2020 të Gjykatës themelore në Gjakovë, Certifikatë e datës 24.12.2012, e datës 15.12.2010, Certifikatë e lindjes e datës 06.07.2020, Vërtetim i datës 07.07.2020 nr.01/632, pliko postare e datës 23.04.2021 me numër R 1391775.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, për vendosjen e kësaj çështjeje ka shqyrtuar të gjitha shkresat e lëndës të parashtruara nga palët dhe ka vërtetuar se ankesa e ankuesit *është e palejuar, sepse:*

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, në bazë të provave të lëndës, ka konstatuar se ankuesi me datë 30.03.2021 ka parashtruar ankesë përmes postes elektronike në E-mailin zyrtar të Këshillit ne adresën: ankesa.kpmschck@rks-gov.net, e pranuar me datë 01.04.2021 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, e cila është regjistruar në këshill me numër A.nr.207/2021 e protokolluar me numër 1528/21, i cili nuk ka pranuar përgjigje në kërkesën e tij, të parashtruar me datë 18.01.2021 tek Kryetari i Komunës së Malishevës, Drejtori i Drejtorisë për Ekonomi, Financa dhe Buxhet, Njësisë së Personelit, dhe Zyrës së Auditorit të Brendshëm, për mos zbatimin e ligjit të shërbimit civil të Kosovës për ndryshim dhe plotësim të Akte emërimit bazuar në punën që është duke e ekzekutuar, për të drejta dhe interesa të punëtorëve, shkelje të ligjit me rastin e konkursit të brendshëm, si dhe diskriminimit dhe pa barazisë në vlerësimin e kompetencës profesionale, meritës, rezultateve në punë dhe kompensimit të punëtorëve, në Komunë të Malishevës.

Mbi këtë bazë, Kolegji ka konstatuar se ankuesi nuk ka zbatuar dispozitën ligjore të ankimimit në pajtim me dispozitën e nenit 127 paragrafi 4 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, ku përcakton se: *"Ankesa kundrejt heshtjes administrative mund të parashtrohet jo më herët se shtatë (7) ditë dhe jo më vonë se dy (2) muaj pas skadimit të afatit për njoftimin e aktit administrativ"*, sepse nga data 18.01.2021 kur ankuesi ka parashtruar kërkesë për ndryshim dhe plotësim të Akte emërimit, deri me parashtrimin e ankesës së datës 30.03.2021 përmes formës elektronike E-mailit zyrtar të Këshillit, e pranuar me datë 01.04.2021 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, e regjistruar me numër A.nr.207/2021 e protokolluar me numë 1528/21, ka tejkalim të afateve ligjore, siç përcaktojnë dispozitat e lartë cekura.

Andaj, Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, pas konstatimit se ankesa e ankuesit është parashtruara jashtë afatit ligjor të përcaktuar në nenin 127 paragrafi 4 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, ka vlerësuar se nuk mund të lëshohet në shqyrtimin e pretendimeve të ankuesit, por ka vendosur njëzëri që ta hedhë poshtë si të palejuar ankesën e ankuesit me numër A.nr.207/2021 të protokolluar me nr. 1528/2021 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në pajtim me nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.7 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës.

Bazuar në këto rrethana, Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, pas analizimit dhe vlerësimit të të gjitha shkresave të lëndës si dhe duke u bazuar në kompetencën e Këshillit, vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Vendimi hyn në fuqi në momentin e nënshkrimit nga ana e kryetarit të kolegjit.

Këshillë juridike: Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë - Departamenti Administrativ, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalin ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
Lënda, A.nr.207/2021, datë 11.05.2021.

Zyle Millaku GOJNOVCI

Zyrtare e lartë për bashkëpunim profesional

Vendimi i dërgohet

- Ankuesit
- Kryetarit të Komunës së Malishevës;
- Udhëheqësit të Burime Njerëzore të Komunës së Malishevës;
- Arkivit të KPMSHCK-së.



[Handwritten mark]